

KONVENTA PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Grupi i Punës III

*(Siguria Ushqimore, Veterinaria, Mbrojtja e Bimëve, Bujqësia dhe Zhvillimi Rural –
Kapitujt 11 dhe 12)*

*Sesioni 1, Tema: Reforma në sigurinë ushqimore / fuqizimi i partneritetit publik-privat për
rritjen e efektivitetit të kontrollit zyrtar*

29 Korrik 2015

Zhvillimet aktuale

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit (AKU) në kuadër të **Reformës në Sigurinë Ushqimore**, synojnë të konsolidojnë sistemin e kontrollit zyrtar duke garantuar kontrollin në të gjitha hallkat e zinxhirit ushqimor nga një autoritet i vetëm dhe si pasoje garantimin e të njëjtit standard kontrolli. Grupi i Punës konsideroi si risi hapjen e bashkëpunimit të drejtpërdrejtë me sektorin privat, shoqërinë civile apo edhe aktorë të tjerë ndërkombëtarë, nismë e cila nënkupton lënie pas të mentalitetit dhe kulturës së punës që çdo gjë duhet realizuar e pritur nga institucionet shtetërore të cilat aktualisht janë të limituara në infrastrukture dhe burime njerezore.

Në kuadër të Reformës, konsiderohet si pozitiv **Sistemi horizontal i përgjegjësive**, ku i vetmi insitucion vertikal do të jetë AKU, ndërkohë që subjekteve private do t'i delegohen funksione (kryesisht inspektuese). Një ndër arritjet e AKU është kontrolli i më shumë se 24000 bizneseve brenda një periudhe prej një vit e gjysëm. Ky fuqizim i partneritetit publik-privat i cili mundësohet edhe nga Rregullorja përkatëse e BE-së, premtion rritje efektiviteti dhe përshpejtimin e rrugës drejt integritimit- më shumë garanci që kuadri ligjor do të zbatohen në mënyrën e duhur.

Grupi i Punës i kushtoi vëmendje dhe **modernizimit të Sistemit të Sigurisë Ushqimore** ku do të krijohet një bazë unitare të dhënash për gjurmueshmërinë e prodhimit. Kjo do të lehtësojë hapjen e eksporteve për blegtorinë, do të rrisë sigurinë ushqimore si edhe konkurrueshmërinë në treg.

Sistemi i klinikave private, ku do të bëhet vaksiminimi i kafshëve do të kenë detyrë të paraqesin raportime të vazhdueshme, të hedhin të dhëna, të kenë trupa të autorizuar, stabilimente prokurimi. Këto shërbime do të paguhen nga operatorë biznesi, si tarifë shërbimi.

Problematika & Rekomandime

- Sipas Grupit të Punës, ekziston një zinxhir i këputur, ku problem përbën **mosmbyllja e reformës së sigurimit ushqimor** e cila për arsye burokratike nuk po arrihet. Duhet një përshejtim i disa ligjeve për të arritur një reformë të thelluar të sistemit veterinar dhe atij të mbrojtjes së bimëve. Në mënyrë që kjo reformë të përfundohet me sukses e në kohën e duhur duhet të sensibilizohet komuniteti kombëtar dhe ndërkombëtar nëpërmjet të tilla tryezash.
- Duke patur parasysh situatën që Shqipëria nuk eksporton dot produkte shtazore, dhe pasjen e një rrjeti tregjesh informale, rekomandohet si prioritet realizimi i një **sistemi të unifikuar të dhënash të gjurmueshmërisë**, i cili do të garantojë siguri ushqimore, do të shërbejë si gjenerator ekonomik, dhe do të krijojë kushte për barazi në treg.
- Konstatohet se ka mungesa të theksuara të specialistëve në radhët e burimeve njerëzore, ku për 24 mijë biznese formale ka vetëm 280 inspektorë të AKU-së. Në mënyrë që të përshejtohet kualifikimi i **burimeve njerëzore dhe për rritje kapacitetesh** propozohen mbështetje me ekspertë ndërkombëtarë që jo vetëm do të raportojnë e monitorojnë por do të jenë pjesë e zgjidhjes.
- Vlerësohet si problematike mungesa e komunikimit dhe një fragmentarizim, i karakterizuar me **mbivendosje kompetencash** ndërmjet institucioneve. Nevojitet një delegim përgjegjësish, pasi njëri ent mund të ketë probleme financiare, tjeri mangësi infrastrukture, etj.
- Grupi i Punës sugjeron që në kuadër të Reformës Ushqimore, Drejtoria e Doganave në bashkëpunim me AKU duhet të kenë **rol më proaktiv**.
- Reforma e sigurisë ushqimore nuk parashikon një kosto rregullatore, të personalizuar për çdo subjekt. Grupi i Punës rekomandoi realizimin paraprak të një **studimi apo vlerësimi të koston** për burimet njerëzore, infrastrukturën e nevojshme.
- Duke patur parasysh 2 grupime: -operator biznesi ushqimor (nga prodhimi, grumbullimi, paketimi, gjer te konsumatori) dhe inspektimi (kontrolli zyrtar) , sugjerohet ti kushtohet rëndësi sistemit gjurmues si dhe konsiderohet domosdoshmëri **paanshmëria e kontrollit**.
- Në ritmin e **avancimeve teknologjike**, duhet të ketë më shumë bashkëpunim me entet publike të avancuara. Të ngrihen **bashkëpunime me institucione të kërkimit shkencor për** labororet – Sistemi i laboratorëve t'i kalojë PPP, ku AKU të ketë rolin e kontraktorit.
- Duke i kushtuar rëndësi ndaj konsumimit të produkteve ushqimore. Institucionet shtetërore në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile dhe median, duhet të realizojnë **një fushatë edukimi dhe sensibilizimi** e gjerë e popullsisë mbi problematikën e sigurimit ushqimor.



Pjesëmarrës në Sesionin I, Grupin e Punës: Institucione shtetërore dhe shoqëri civile

Institucione shtetërore :

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave Drejtoria e Mjedisit - Alban Zusi, Zv. Ministër

Autoritetin Kombëtar të Ushqimit(AKU)- Afrim Bakaj, Drejtor i Përgjithshëm i AKU

Geron Kamberi- Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit AKTI

Shoqëri Civile :

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar- Agim Rrapaj, (Kryetari), Ymer Tola, (Drejtor Ekzekutiv)
Agron Rromilli(KASH,Durrës), Shkëlqim Agolli, Enida Shena, Ylli Shena

EKR -Endrit Rrapaj

Butrinti Fermë- Albert Pashaj

Ekspert i Grupit të Punës EMA- Florian Xhafa

Dhoma Kombëtare e Avokatisë- Kadrije Gurmani

Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor- Abdyl Tabaku

GBE Herbs- Irgels Myftaraj

CSA- Malber Dibra

SH B B Agroservis- Dritan Zaimi

Media- Entela Barjamaj(SCAN TV), Anduena Nika